



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Blv. "Gjergj Fishta", Tiranë.

Nr. Prot.

Tirane me date 17.06.2019



PROCESVERBAL

I mbajtur sot në datë 17.06.2019, nga sekretare gjyqësore Lorena Bellovoda, në zyrën e Kryetarit të Gjykatës (Dhoma Civile), në prani të anëtareve të Këshillit të Gjykatës: Zv/Kryetarit Z.Petrit

Qomo, Kancelarit Z.Donald Xhelili, gjyqtar Z.Altin Shkurti

Zv/Krvetari: Deklarojmë të hapur mbledhjen e Këshillit të Gjykatës, pas vendimit të KPK për shkarkimin nga detyra të Kryetares

Zj.Enkeledi Hajro, në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit 98/2016

“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ftohet të marrë pjesë gjyqtar Altin Shkurti. Cfarë çështje mendoni të diskutojmë dhe çfarë mund të ketë mbetur pezull.

Kancelari: Ka mbetur pezull projekti për ndarjen në Seksione të Gjyqtarëve. Pasi janë mbledhur kërkesat e tyre për të parë nëse ka apo jo, kërkesë për ndryshim seksioni.

Zv/Krvetari: Legjislacioni nuk parashikon ndërrimin e seksioneve. Në fakt,

unë mendoj që duke patur parasysh edhe profilin e secilit, gjyqtarët të qëndrojnë në seksionet që janë, kjo duke patur parasysh që kemi edhe rastet e delegimeve. Megjithatë, psh një sugjerim mund të ishte bashkimi i seksionit tregtar me atë civil.

Kancelari: Nuk është e thënë të ndryshohen, por ligji thotë çdo dy vjet, madje mund të ngrejme edhe seksione nëse është e nevojshme.

Altin Shkurti: Edhe luksin për të lënë disa gjyqtare vetëm me Urdhëra nuk e kemi. Unë jam për ndryshime të vogla.

Zv/Krvetari: Duhet parë edhe ngarkesa e secilit seksion.

Altin Shkurti: Mund të ngarkohet me shumë seksioni civil e tregtar me urdhëra ekzekutimi.

Kancelari: Edhe tek Dhoma Penale, është e rëndësishme që trupi gjykues të ketë bashkëpunim me njeri-tjetrin.

Zv/Krvetari: Ligji thotë të paktën çdo dy vjet. Kancelar, duhet parë ngarkesa e cdo seksioni; mund të caktoi dikë tek sekretaria të shohin ngarkesën e do seksioni.

Kancelari: Lidhur me rivendosjet në afat, kemi problemin e rasteve kur dosja e rekursit ka tre vjet që ndodhet në Gjykatë të Lartë, ndërkohë ankimi është depozituar, mund të ketë tre vjet këtu.

Zv/Krvetari: Si mund ta zgjidhim?

Kancelari: T'i drejtohem me shkresë Gjykatës së Lartë, të dërgojnë një kopje të dosjes, të bëhet një rakordim.

Zv/Krvetari: Nëse nuk kemi çfarë të diskutojmë tjetër, po e deklaroj të mbyllur mbledhjen, ju falenderoj për pjesëmarrjen.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

